


## BARAZIA GJINORE, ADRESIMI I DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE COVID-19

- Komunikimi me gra e vajza, të mbijetuara të DHBGJS, dhe informoni për çdo ndryshim të mundshëm në ofrimin e shërbimeve duke marrë parasysh këshillimin në distancë.
- Siguroni rregullisht informacionin mbi mekanizmat mbështetës dhe njoftimet.
- Siguroni përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj dhunës seksuale e pasojave të saj, duke përfshirë këshillimin, strehimin, linjat telefonike, parandalimin e trajtimin. Referojuni udhëzimeve të shëndetit dhe shërbimeve sociale të Paketës së Shërbimeve Thelbësore.



*Opinionet e shprehura këtu janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNFPA*

## ADOLESHENTËT DHE TË RINJTË DHE COVID-19



- Në periudhat e zgjatura të mbylljes së shkollës e kufizimet e lëvizjes, nëse prindërit/kujdestarët infektohen, izoloohen ose vdesin, duhet të adresohen ceshtjet e mbrojtjes psiko-sociale për adoleshentët.
- Në kohë krize, adoleshentët dhe të rinjtë kanë nevojë për informacione të menjëhershme dhe të përshtatshme për moshën. Gjatë mbylljes së shkollës duhet të mirëmbahen mekanizmat mbështetës dhe siguri i shërbimeve shëndetësore.

Mbështetur nga:



QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN  
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

*“Kontaktimi me mjekun e familjes për çdo nevojë, shqetësim apo referim tek mjeku specialist për kujdesin ndaj shëndetit seksual dhe riprodhues”.*

# OFRIMI I SHËRBIMEVE GJATË EPIDEMISË SË

# COVID-19

## ➤ KËSHILLIMI PËR SHËNDETIN SEKSUAL E RIPRODHUES

- Ofroni këshillim mbi shëndetin seksual e riprodhues përmes telefonit ose mjete të tjera dixhitale-skype, zoom, whatsapp, etj, si dhe në mjediset e kujdesit shëndetësor duke respektuar masat për mbrojtjen nga COVID-19.



## ➤ METODAT KONTRACEPTIVE MODERNE DHE NEVOJAT PËR FURNIZIME MJEKËSORE PËRFSHIRË ATO PËR PARANDALIMIN, MBROJTJEN DHE PËRGJIGJEN NDAJ COVID-19

- Ofroni këshillim, ndjekje dhe takime për metodat kontraceptive afatgjata të kthyeshme dhe shërbimet e referimit përmes telefonit ose metodave të tjera virtuale.
- Sigurohuni për masat mbrojtëse shtesë të miratuara, kur ndërmerri procedura mjekësore që kërkojnë kontakte të ngushta (p.sh. futja ose heqja e DIU dhe sterilizimi kirurgjikal).
- Planifikoni rezerva të metodave kontraceptive për institucionin tuaj.

## ➤ KUJDESI PËR ABORTIN

- Ofroni këshillime dhe konsulta para e pas abortit përmes gasjeve në distancë si telefoni si dhe në mjediset e kujdesit shëndetësor duke respektuar masat për mbrojtjen nga COVID-19.
- Vazhdoni të ofroni shërbime të integruara të abortit dhe kontraceptiveve, duke vlerësuar zgjedhjen individuale, nëpërmjet takimeve paraprake, që institucioni të jetë i përgatitur për të trajtuar fluksin e klientëve, me masa të parandalimit të COVID-19.

## ➤ INFEKSIONET SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME/HIV/AIDS DHE COVID-19

- Rekomandoni menaxhimin sindromik të IST-ve për klientët dhe partnerët e tyre sipas udhëzimeve kombëtare.
- Përshtatni shërbimet që klientët të marrin këshillime dhe konsulta lidhur me IST/HIV/AIDS duke ndjekur masat anti COVID-19.
- Siguroni aksesin në mjekimin antiretroviral dhe medikamente për infeksionet oportuniste.



## ➤ SHËNDETI I NËNËS E I TË PORSALINDURIT DHE COVID-19



- Nëse shërbeni në zona të largëta kërkon për shenjat e rrezikut në shtatzëni.
- Inkurajoni klientët të rishikojnë planet e tyre të lindjes, sipas kushteve lokale.
- Mbështesni nënën e të porsalindurit për: ushqyerjen e sigurt me gji, mbajtjen e bebit në kontakt lëkurë me lëkurë, mbajtjen e foshnjës në të njëjtën dhomë me të, larjen e duarve para dhe pas prekjes së foshnjës dhe mbajtjen pastër të të gjitha sipërfaqeve.
- Gratë me COVID-19, mund të ushqejnë foshnjat me gji, nëse dëshirojnë, duke u këshilluar: të lajnë duart shpesh me ujë e sapun ose dezinfektues, sidomos përpara prekjes së bebes, të mbajnë maskë mjekësore gjatë cdo kontakti me foshnjën.